

ZAMIRA ALIMEMAJ

VEÇORI TË SISTEMIT LEKSIKOR TË LABËRISHTES

Hyrje

E folmja e Labërisë karakterizohet nga një leksik shumë i pasur me veçori individuale, ku kanë lënë gjurmë ngjarjet historike, veprimtaria prodhuese e shoqërore, jeta kulturore e artistike si dhe marrëdhëniet me vendet fqinjë. Me vlerë mijëvjeçare është një mbishkrim në gjuhën shqipe i shkruar në një mozaik të gjetur në fshatin Mesaplik, që i përket shek. VI të erës sonë. Mbishkrimi thotë: A-PAK-KE-TAÇ i cili i deshifrohet: *Po hëngre pak (të kursesh), ke të hashë*.¹ Gjatë pushtimeve në periudhën e mesjetës banorët vendas në Labëri bashkëjetuan me ardhësit duke bërë asimilimin e tyre, por, gjithsesi, ata lanë një shtresë kulturore. Kontaktet dhe ndikimet kulturore të huaja, të cilat kanë lënë gjurmë në kulturën material dhe shpirtërore të banorëve vendase në Labëri, nuk mund të injorohen. Ndikimet e huaja vihen re në inventarin leksikor, emërtimet e njerëzve dhe të vendeve si dhe në zëvendësimin e shumë fjalëve dhe emërtimeve shqipe me njësi greke, latine, sllave apo turke. Elementet prej këtyre gjuhëve kanë formuar dukuri e huazime gjuhësore në të folmen e Labërisë.

1. Ndikimet e huaja në leksikon e labërishtes

E folmja e Labërisë ka një leksik të pasur, i cili, përveç veçorive individuale që shfaq, ka edhe tipare të përbashkëta me të folmet e tjera të toskërishtes, sidomos përsa u përket huazimeve.

1.1. Ndikimet greke

Greqizmat janë më të shumta në të folmen e Bregut të Detit, kjo si pasojë e marrëdhënieve të ngushta ekonomike me Greqinë (Korfuzin). Një ndikim të madh në huazimet greke pati hapja e kishave dhe shkollave greke në këtë zonë. Greqizma vërehen më shumë në sferën e detit dhe të mjeteve të lundrimit e më pak në sferat e tjera. Greqizmat vërehen edhe në sferën e marrëdhënieve intelektuale. Sfera më pak e prekur nga greqizmat është ajo e blegtorisë² si p.sh.:

afendiko, adhjas (pastroj), *akoma* (ende), *allonar* (korrik), *avlli* (oborr), *bango, cimbis* (pickoj), *cimidh* (mashë), *dhaskal* (mësues), *dhogë* (dërrasë), *eftaristisa* (kënaqa), *faneps, farmak* (helm), *farmakos, feks* (ndriçon), *fermeridhe* (grindavec), *gjiton* (komshi), *gremis, kallamar* (enë për bojë), *kallamboq* (miser), *kallogre* (murgeshë), *katandi* (pasuri), *katandis, kokalli* (kockë) *ksodh* (vaki, vdekje), *kumbisem* (mbështetem), *kunup* (mushkonjë), *kuturis* (veproj), *kuvli* (kafaz), *langua* (qen), *lipset* (duhet), *livadh, llagariset* (kthjellohet), *llahtaris, lolo* (budalla), *mandate* (lajmi i vdekjes), *mballomë* (arnë), *mbodhis* (vonohet), *moleps,*

¹ I. Mati, *Mozaiku i Mesaplikut*, "Gazeta Shqiptare", datë, 30 shtator 2006.

² M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, SF, 1964/2, f. 125.

mollois (tregoj), *nikoqire*, *nome* (kullotë), *ormis* (përgatit), *paparune* (lulëkuqe), *pataks* (*tremb*), *patomë* (shputa e këmbës), *podhe* (strehë), *potis* (*ujis*), *proftas*, *psonis* (*bëj pazar*), *qeramidhe* (tjegull), qir (zotëri), *qivur* (arkivol), *radhë* (rresht), *rokanis*, *shastis* (humbas), *shpirto* (shkrepse), *sikteris* (përzë), *sinor* (kufi), *skutinë* (pelena), *shqepi* (pjesë e verandës), *stafidhe* (rrush i thatë), taksidh (udhëtim), *thiatro* (teatër), *toidhio* (njëlloj), *trapez*, *zali* (të fikët, vilani), *zileps* etj.

1.2. Ndikimet sllave

Ndikimet **sllave** gjenden me shumicë në leksikun bujqësor e blegtoral por edhe në atë të përgjithshëm si p.sh.:

bejkë, *belec*, *bigorr* (çmërs), *bran* (zvarrë), *branis*, *brashnje*, *cfrat*, *cipal*, *çelnik* (kryetar i barinjve), *çetur*, *darovë* (dhuratë), *dërstilë*, *dorovit*, *dërstilë*, *drënjë*, *gërrec*, *gjinë* (argjil), *kapicë*, *kobë*, *kobit*, *kosore*, *koritë*, *krinë*, *latë*, *lesë*, *luath* (livadhe), *meçkë*, *mezhdë*, *mrezhë*, *moqilë* (hauz), *përç*, *paparunë*, *pestrovë* (troftë), *ponovë* (tokë e punueshme), *rezhdë*, *selit*, *sillë* (mëngjes), *tërsirë*, *vidhër* (kastor), *rrazhdë* (hoje të prishura), *rezhdë* (dy lila që i zgjaten kesit në gushë), *roit*, *vockë* (enë druri), *zhivar*, *bist*, *bistër* (e thartë), *breg*, *buhavitet* (fryhet), *fertile* (copë e çikë), *çetë* (grupë njerëzish), *godis* (qëlloj), *gorricë*, *kamatë*, *karkalec*, *kërmë*, *klloçkë*, *kockë*, *kolibe*, *kosh*, *koshere*, *kopaçe*, *kovaç*, *kotec*, *kovë*, *kurvë*, *lopatë*, *lugat*, *memec*, *mogile* (varr), *përç*, *plaçkë*, *ponovë*, *selit*, *sillë*, *sisë*, *stan*, *sokëllin*, *shparth* (lloj dushku), *tërkuzë*, *tërsëri*, *tutkun*, *velënxë*, *vërvit*, *vërsnik* (moshatarë), *vërvit*, *vidhë*, *vidhër* (kastor), *vockë* (enë uji), *zakon*, *zbras*, *zvor* (burim), *zhiva* (helm), etj.

1.3. Ndikime turko-arabe

Nuk janë të pakta edhe ndikimet **turko-arabe** të cilat mund t'i gjejmë në leksikun e përgjithshëm, në toponime dhe antroponime. Elementet turko-arabe gjenden më shumë në pjesën e brendshme të Labërisë dhe, pothuajse, nuk gjenden fare në zonën e Bregdetit të Poshtëm. Disa prej fjalëve të huazuara nga **arabishtja** janë:

aman, *avdall*, *çull* (qilim), *haber*, *hair*, *hashure*, *matarà* (enë), *merak*, *neps*, *noksan* (i bezdisshëm), *nur* (bukuri), *sënduk*, *siklet*, *verem*, *xhade*, *xhonet*, *xhevap*, *xhezve* etj.

Fjalët e huazuara nga **turqishtja** përbëjnë një shtresë gjuhësore që paraqet interes gjuhësor e social-kulturor. Ndikimi i osmanishtes në gjuhën shqipe ka qenë kryesisht urban, sepse ka depërtuar fillimisht në qytete dhe vetëm shumë më vonë është përhapur edhe në zonat rurale.³ Disa prej huazimeve osmane gjejmë përdorim edhe në të folmen e fshatrave labe si për shembull:

alamet, *aksham*, *ashiqare*, *avash*, *azat*, *baçe*, *bakllava*, *ballajdi*, *bashibozuk*, *bedena*, *bakshish*, *basma*, *batak*, *batakçi*, *batall*, *baxhanak*, *bejte*, *biçak*, *biçim*, *birinxhi*, *bina*, *bollëk*, *biçak*, *burani*, *boftan* (shpifje), *çakmak*, *çanak*, *çatma*, *çati*, *çekiç*, *çibuk*, *çifçi* (bujk), *çivi*, *çitjane*, *çurek*, *çyryk*, *damkë*, *damlla*, *dava*, *davet*, *debil*, *dedë* (gjyshe), *dehurdexhi* (roje), *deli* (i mirë), *derhem* (njësi matëse), *derman*, *dert*, *dervish*, *dollap*, *dolli*, *dollibash*, *duvak*, *dyfek*, *dynym*, *dyshek*,

³ M. Kore, *Gjirokastrë, vështrim historik, gjuhësor, etnologjik*, Tiranë, 2014, f. 197.

dyscheme, esnaf, evlat, ezmer, fajde, fakir, fall, fener, feste, fiqir, fitil, fustan, futë (përparëse), *gafil, gajret, gajtan, gazeq, gjerdek* (oda e nuses), *gjezdis, gurgule, hamall, haraç, harbi, havale* (bezdi), *helbete* (pa dyshim), *hise, hizmet, ilet, inxhi, jakë, kabull, kabuni, kadaif, kafaz, kafe, kallauz, kallëp, kallkan, kamare, kandil, kapsllëk, katil, kazma, kërbaç, kërdis, kismet, kopil, kravatë, kum, kumar, kurban, kurdis, kusar, lanet, llaf, llagap, llapà, mandër* (stan), *mangall, manushaqe, marifet, marshalla, matara, matuf, meazallah, mejdan, melhem, mesele, midë, muhabet, muhalebi, muhamedan, mukajet, mushama, muslluk, naze, nishan, nur, nursëz, oxhak, pajë, parmak, patllake, pehriz, peshqir, pusullë, qafiri, qeder, qederi* (humbja), *qelepir, qepaze, qibar, qoshe, qulaf, sahan, sahat, salltanet, satrap, sefte, sehir* (shikim), *selamet, sevda, shamata, sultiaç, taban, tabiat, takat* (fuqi), *taksirat, tavan, taze* (e freskët), *telendis* (turpëroj), *tepsi, terezi, turli, turshi, vaki, vakt, venome* (rregulla), *veresie, xhade, xhevahir, xhevap, xhevze, xhivar* (mbledhje), *xhuma* (e premtë), *yrç* (sulm), *zagar, zahar* (sheqer), *zarar, zeher* (helm), *zengjin, zevzek, zili, zullum* etj.

2. Leksiku nga fusha e pajisjeve shtëpiake

Kultura materiale e një populli përbën një pjesë të rëndësishme të kulturës së tij në përgjithësi, prandaj dhe studimi i saj paraqet interes të madh për njohjen konkrete të mënyrës së jetesës, të aftësive krijuese në disa fusha të jetës. Vëzhgimi i elementeve të kulturës materiale e shpirtërore sjell një varg dëshmish që provojnë se banorët e sotëm të Labërisë janë pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve kaonë dhe se kanë jetuar brez pas brezi në trojet e sotme. Ndër këto elemente, një vend të rëndësishëm zënë orënditë shtëpiake. Nga përqsja e orëndive që janë përdorur në Labëri në të kaluarën jo të largët me gjetjet arkeologjike, etnografët kanë vënë re mjaft përkime, të cilat dëshmojnë për prejardhjen iliro-epirote të popullsisë së kësaj krahine. Deri nga fundi i shekullit XVIII orënditë shtëpiake ishin të pakta dhe kryesisht, të prodhuara në vend. Nga fondi i vjetër i leksikut të orëndive shtëpiake kemi veçuar disa prej tyre:

baçkalloma (enë e vjetër, jashtë përdorimit), *baltë çerepi, bardhak, barkaçe* (kusi e vogël prej bakri), *berduveli* (cope hekuri që mban të mbyllura kanatat), *bixhak* (brisk), *bode* (shtambë), *bucela, buhar* (oxhak, vatër), *bushi, buxhat* (nyje te lisave), *ceka* (sëpatë e vogël), *cyrla, çarki, çekmexhe* (komodinë), *çengeli, çepërkë* (kasolle, shtëpi), *çitës* (krehër me dhëmbë të gjatë), *çininjtë* (enë për verë), *çiraku, çinak* (maja e oxhakut), *çoçonar* (kyç), *demiroxhaku* (magjar, unak, urëz, shufër hekuri), *dyshek me lesh, dyshek me byk, dyshek me myshnjë, dyokare* (enë për mbajtjen e verës), *dhëmbecër* (krehër), *dhogë* (dërrasë), *dhokan* (çarku që zë minj ose kafshë të tjera), *dhoksal* (dru ku çobanët varin kusinë kur e ziejnë diçka), *dhrihalë* (cfurk), *dymbeku, dyokare* (enë për matjen e verës), *farashan* (mbajtëse e kripës), *feliç* (druri që rrihej bulmeti në dybek), *fjesë* (fshesë), *fllocka uji* (enë druri për ujë), *foti* (ndriçues), *furra, gjuveç* (tepsi e vogël e thellë), *gjym, furrustidhe* (pllakore gruri), *hajkoma* (kusi bakri), *havana* (enë kuzhine) *ibrigu, jamake* (tenxhere për gjellë), *hajkomë* (kusi e vogël bakri pesë kg.) *kaceku* (sufër, kaçup, enë prej lëkure), *kaçupi, kakame* (kusi e vogël), *kade* (enë druri), *kamare* (dollap muri), *kambalec, kanape* (sirtar), *kanatolli* (vedër e mesme), *kandili, kardhon*

(dërrasë për shtrimin e shtëpisë), *katoqe* (bodrum), *kërbuzët* (drutë e zjarrit), *kërcu*, *kërraba e zjarrit*, *kërsërë* (sitë), *kocaqe* (pjesë e samarit), *konak* (shtëpi), *kongjilli*, *kotruve*, *kovatë*, *kraba* (për vjeljen e ullinjve), *kremastari* (për varjen e kuisë mbi zjarr), *kresa* (thikë që përdoret për të kruar kungullin), *krina* (arkë që përdorej për të mbajtur miellin), *krobur* (koshere), *ksami* (karrige), *ksoq* (kotec), *kudhe* (kusi e madhe), *kupa*, *kupecë* (enë druri), *kuvli* (kafaz), *liçe* (enë qelqi), *locker* (dry), *llërë* (shul që mbyll derën nga brenda), *lluqetë* (dryn), *magjëria* (dhoma e zjarrit), *magjet* (për mbrujtjen e bukës), *magjia*, *manxato* (dhoma ku rrinë fëmijët), *masha*, *mashan*, *matrak* (shati i furrës), *matraku* (shërbente për nxjerrjen e bukës nga furra), *mazdrak*, *mësallë* (pëlhurë që shtrohej si mbulesë), *naftarë* (çelësa), *nasqiris* (bëj punët e shtëpisë), *nënkrezë* (jastëk), *nim* (minder), *nome* (kasolle), *odë*, *panxha* (brava e derës), *pilla* (qyp i madh për vaj), *pilla* (qypa prej balte), *pirostia*, *plloçkë* (dryn), *piqer* (gotë rakie), *poçia* (enë prej bakri), *proshqefall* (jastëk), *qebap* (pjekës i kafesë), *qepër* (tra i kulmit të shtëpisë), *qeri* (shërbente për të hedhur bukën në vatër), *qeramidhe* (tjegulla), *qiçe* (çelësa), *qisti* (levë), *rrepe*, *saç*, *sahan*, *sakaturë* (sëpatë e vogël), *sapllak*, *sendon* (çarçaf), *sepete*, *kryporja* (arka e kripës), *sergjen* (objekt zbukurimi i dhomës së miqve), *shakulli* (enë lëkure), *shelqëror* (dru dëllinje ku vendoseshin napat e djathit), *sheshij* (rrobë që shtrohet përtokë), *shilte*, *shkarpa*, *shkallë* (ballkon i madh në hyrje të shtëpisë), *shosha*, *skutina* (veshje të fëmijëve të vegjël), *sofra*, *spithar* (kunj druri), *squire* (pjatë farfurie), *squire* (pjata për ngrënie), *squretë* (pjata për ngrënie), *stroma* (minder), *sufër* (trastë lëkure), *tabaqere* (tavëll), *takëme* (orendi, sende), *talëri* (enë druri në formë cilindri), *tepsi*, *trapezë* (tavoline), *thollo* (vend në katua), *vargu* (objekt i zjarrit), *vatra*, *vedra* (enë druri), *vegje* (fije të holla leshi), *xhanake* (kupa druri), *ydllek* (dollar), *zhak* (masha prej druri), *furka*, *ledhi*, *mbrezhda*, *mezhdha*, *monetë* (tendë, kasolle), *musha* (zone e lire), *shkarpa*, *shtredhi* (kasollja ku përpunohet qumështi), *shtrojërat* (për bagëtinë), *shtrungo* (hyrja e dalja e dhenve nga vathi), *skërat*, *stanëtoret* (çobaneshat), *vërri*.

3. Leksiku nga fusha e gatimit

Një ndër treguesit e prekshëm në kulturën e një populli, mbetet mënyra e jetesës. Edhe mënyra e të gatuarit konsiderohet si një nga shfaqjet e hershme të kulturës në përgjithësi. Etnologët thonë se, ushqimi është bashkudhëtare e njeriut, së bashku me veshjen dhe me banimin. Kundruar kështu, mënyra e të gatuarit dhe ushqyerjes mbetet dëshmi historike dhe kulturore, për cilëndo etni, komb a popull me rrënjë të hershme ngulimi në trojet e veta. Në Labëri baza ushqimore e gatimit ishte kryesisht blegtorale, sepse blegtoria përbënte burimin kryesor të jetesës. Në fushën e leksikut çështjet që mund të trajtohen janë të shumta, por me interes do të ishte edhe trajtimi i emërtimit të sferës së gatimit e ushqimit tradicional në Labëri.

aguridhe (e papjekur), *arapash*, *babanace* (bukë misri), *bollguri* (peta, grurë dhe qumësht), *bujashkë* (bukë e bardhë), *bukë e ardhur*, *bukë e mbrume*, *bukë e ndorme* (bukë pa maja), *bukëvale*, *bukëfiqe*, *byrek me hithra*, *byrek me lëpjeta*, *cujgë* (frut i pjekur shumë), *byrek me të përbrëndëshme*, *çorbë djath nape*, *djathi i marrë* (gjiza), *dobroçka* (byrek me zorrë bagëtie), *dollmë*, *gaç* (kafshatë), *gjalpë e gjizë*, *hallvë*, *harxhërat* (ushqimet), *hasude*, *hirrë*, *hiseja* (pjesa), *hosa* (rosnica,

makarona shtëpie) *japarak, jahni, jani, kabuni, këmbëkuqi* (byrek me miell gruri ose misri), *kiçimite, kilë* (bukë e pjekur në hi), *kokordhokë gruri* (kuleç të vegjël), *kolloface* (zorrë e mbushur me copa mishi e miell), *krinë* (hambar), *kukurec, kulaç i situr, lakra prakalidhe, lëngërishte*, (gatim me dhjam bagëtie), *llallë, marash me miell e djath të ëmbël, manestra* (byrek me makarona), *mblatë* (bukë që përdoret për ceremoni fetare), *mëllë* (kafshatë), *mullë qengji, mushtë, paranike* (bukë e mbrujtur me miell misri), *papare, palcarë* (misra të njomë), *paparunde* (lulëkuqe pa lule), *pastërma* (mish i ruajtur në kripë), *peshnik* (bukë gruri), *përshesh, përshesh me lëng mishi, përvëlak* (me bukë të shkoqur), *përvëlak, petanik, petat, petulla, pikël* (fryt i pjekur), *pipek me miell, pispili, pjatat e squiretë* (pjata ngrenieje), *pshier* (djathë i njomë), *purriq* (presh i egër), *qëret* (shërbente për hedhjen e bukës në furrë), *qollopitë, qullë, qumësht sufte, reshedi, shefteli* (pjeshkë), *qumësht kulloshtë* (kaceku), *qumësht në lëkurë* (përzierje me urël, gjizë e djathë), *reshedi, ris* (oriz), *rosnicat, rrëna* (mulla me të cilën zihet djathi), *samsa, simite* (bukë e bardhë) *strufullake* (bukë e hollë), *shkota qengji ose keci, shtalpë, të brësme, të lyerit* (vajrat dhe yndyrnat), *të thartë* (limontoz) *trahana, turshi, urrël, yshmer, zahire* (ushqime rezervë).

4. Leksiku nga fusha e blegtorisë

Ashtu si bujqësia, edhe blegtoria si zeje ndër më të vjetrat ndër shqiptarë, në vete përmbajnë një pasuri të pashtershme gjuhësore që deri më tani janë studiuar shumë pak.

Veprimtaria blegtorale që ishte jetike për vendasit dhe për u zhvillua kryesisht në vise malore, sepse atje më lehtë krijoheshin kushte të përshtatshme për këtë degë ekonomike.

Hulumtime etnolinguistike në veprimtarinë blegtorale të Malësisë së Labërisë, krahas punës dhe mundimeve, këtyre banorëve u mundësonte edhe kënaqësi.

Gjuha e vendasve në këto segmente të komunikimit na del shumë e pasur. Blegtorët dhe jo vetëm ata, me kohë e kishin ndërtuar gjuhën e kësaj veprimtarie jetike për këtë popullatë. Ky komunikim i ka edhe karakteristikat e veta në fushë të leksikut të frazeologjisë, të toponimisë dhe të gjuhës në përgjithësi, si mjet komunikimi. Gjuha e fushës së kësaj veprimtarie është e pasur me plotë fjalë të vjetra shqipe. Ky leksik i pasur, në vete përmban shumë fjalë e shprehje që dalin me forma gramatikore që i përgjigjen edhe gjuhës së sotme.

Dhëntë: *bejkë-a* - (delet e bardha), *berr* (një kokë bagëti), *cigaja* (dele), *çukë* (delet që i kishin veshët të prerë), *çulla* (delja me veshë të vegjël), *delmerë* (dele), *desh, dhën barsa, gaçe* (dele e dhi që pjell para se të mbushë dy vjeçe), *gjëja e gjallë* (bagëti, kafshët), *kabadhë* (dhi me pika ngjyrash të ndryshme), *kaleshe, kasape* (bagëti për shitje e therje), *karabash* (dash me vija të zeza në faqe), *katarosh* (dash me katër brirë), *kreshpë* (delet me lesh të ashpër), *kenë* (dhi e murrme), *kërrutë, kuaca* (dele me fytyrë të kuqe), *llaje* (delet e zeza), *llajush* (dash i zi), *mazha, mazhgan* (dele e mazhër me pika të zeza në trup), *musha* (kulloshtë), *nome* (vathi ku rri bagëti), *pëlla* (dhëntë dhe dhitë që pjellin) *plehëron, rrëbunja* (bagëti që ka qumësht shumë), *rruz* (delja 6 deri 12 muaj), *rude* (leshbutat), *rrungajë* (bagëti e vjetër), *shelegë, shqerra, shterpa, shyti* (dash pa brirë), *sorkë*

(delet që i kishin faqet ngjyrë kafe ose të zeza), *syskë* (delet që në anën e syve ishin ngjyrë kafe), *shtredhi* (kasolle e gurtë në të cilën përpunohet qumështi), *shtrunga* (vendi ku çobanët mjelin bagëtinë), *vakër* (dele me fytyrë të zezë), *verger* (dashi që mbahet për damaz), *zhapa* (lëkura e bagëtisë).

Dhitë: *balë* (dhi me një shenjë në ballë), *balëzebë*, *bardhekoçe*, *bardhoshe-bardhoshe*, *barxa* (dhi e bardhë), *bërnjak* (keci apo qengji kur shkëputet nga e ëma), *brihala* (dhi me brirë të drejtë), *brikacale* (dhi me brirë të hollë e të mprehtë), *brirëthe* (dhi me brirë të përkulur), *buçkë* (dhi e zezë me dy vija të kuqe syve), *buzmushka* (dhi e mëllënjër me buzë të bardha), *cangadhe* (dhi që mbahen pranë shtëpisë për qumësht dhe pleh), *çipa* (dhi me veshë të vegjël), *cjapi larash*, *çuka* (dhia me veshë të vegjël), *çulla*, *çullbejk*, *çullllaj*, *çullkuac*, *çullsisk*, *dhia larë*, *dijar* (dhi që ka pjellë dy herë), *dishe* (dhi që ka pjellë dy herë), *drenjë*, *fuj* (dhi 6-12 muaj), *fismë* (cjapi që mbahet për damaz), *flurë* (dhi e bardhë), *protojen* (dhi 1-2 vjeç), *gunga* (dhi që i ka thumbat e sisëve të gjatë), *gjosë* (dhi e zezë me vija të bardha), *kabadhë*, *kenmug*, *kenpëllumbe*, *kokken*, *kokverdh*, *kokzeb*, *koç* (cjap me një bri), *koçken*, *koçlar*, *koçmëllënjë*, *kurra* (dhi e murrme si në të kuqe), *me llapa* (dhi me veshë të varur), *llapbalzezë*, *llapbardhë*, *llapken*, *llapmëllënjë*, *llapzeb*, *llapzebkën*, *mëllënjë* (dhi e zezë), *muga* (dhi ngjyrë hiri e mbyllur), *murrë-murrash*, *mushkuqe* (dhi në ngjyrë të kuqërreme me pika), *mushkiskë*, *pëllume* (dhi në ngjyrë pëllumbi), *protojene* (dhi e vogël, e papjellë), *qerbmushk* (dhi e kenër me faqe të kuqe), *rrepë* (dhia pjesërisht e kuqe, pjesërisht e kenër), *shterpuar* (dhia 2-3 vjeçe), *shyta* (dhia pa brirë), *të mushkëra* (dhi me ngjyrë gri), *thimë*, *verdha* (dhi në ngjyrë si në të verdhë), *verdhë-verdhoshe*, *vrizë*, *zebë* (dhi e zezë me vija të bardha në fytyrë).

Sipas ngjyrës së vijave formohen kompozita dyemërore: *balëzebë*, *lardrenjë*, *larmushkë*, *zebthinë*, *zebvijabardhë* etj.

Sipas formës së brirëve formohen kompozitat: *brirrethe*, *bricjape*, *brishule* etj.

Gjedhët: *bale-balash*, *bërdhëra* (lope e bardhë si në ngjyrë hiri), *kau kazi*, *kau kazil*, *kau larash*, *lopa e zezë*, *lopa larë*, *mëshqerrë*, *mëzak*, *verdhë-verdhan*.

Kuajt: *at* (kalë ku hipte nusja) *balash* (kalë me qime të zeza e pjesërisht të bardha), *çil*, *çuç* (gomarë i plakur), *hati*, *jle* (krifë e kalit), *kapte* (pjesë e samarit), *kali kuqali*, *kërriçe* (mushkë të cilës nuk i është vënë samari), *kërroç* (gomar të cilit nuk i është vënë samari), *kocaqe* (pjesë e samarit), *larash-larë*, *lele* (flokët e kalit), *mëshal* (mëz), *pelë e bardhë-bardhoshe*, *pelë e kuqe*, *shalorë* (kuaj shale).

Qentë e stanit: *arap*, *balo*, *bardhan* (qen i bardhë), *bardhosh*, *belec*, *garo*, *greko*, *këmbëbardhë*, *koqinë* (qusheshin qentë nga barinj të labë), *korbec*, *kurbec* (qen i zi), *laro*, *lupo*, *murgo*, *pipino*, *qyrko*.

Lethpër (dhelapër), *gjirak* (skifter), *stravastrua* (shqiponjë), *curkthi* (akrepi), *brestkostra* (bretkosa), *meshkë* (mushkonjë), *verbeza* (insekte fluturuese), *ushënjëz* (shushunjë), *monomaridhë* (nepërkë me dy koka), *neprëngtë* (nepërkë), *veshtull* (zvarranik).

Punimi i leshit: *argali* (tezgjah), *avlemend*, *boshti*, *çitanik* (gjalmë), *çkorsa*, *çkulet e leshit*, *çuje*, *dërstilë*, *derstilimi*, *dredhja me pulqerët e gishtave*, *drugë*, *duaj* (njësi mase), *dhëmcëri* (mjet për punimin e leshit), *finjë*, *fjolla* (gjeshtë), *flokate*, *furkë*, *hejbe*, *kaç*, *kaçova* (gratë që punojnë në tezgjah), *kopani*, *krehja e leshit*, *lashnik* (velenxë), *lëmshi*, *lësheia* (rrobë leshi që i shtrohet fëmijës në djep), *leshi i bishtrave*, *lëvrime i leshit*, *masurët*, *mjeda*, *palëzim i leshit*, *pashë me gjalmë*, *peri majë*, *plafe*, *posta* (lëkura e bagëtisë me lesh), *postiqe*, *povexga* (brez që lidhen fëmijët në djep), *prokofi*, *qethja, qoftë largu* (shejtani), *ravok* (shkul leshi që mblidhet në dore), *shkorsa*, *shpërgënjë*, *shtëllunga e leshit*, *sixhade*, *strajca*, *stroma*, *tërkuza, tjerrë*, *uji i lugut*, *vegje*, *velenxa*.

Pjesët e argalisë: *gjalmi*, *gjilmitri*, *kanuli*, *këmat*, *kopani*, *krehëri*, *lisi*, *mjeda*, *pështjellësi*, *stromat*, *tefea*, *tërkuza*.

3. Leksiku për veshjen

Specifika etnografike e një populli përcaktohet nga një varg manifestimesh të kulturës materiale dhe shpirtërore të tij. Veshja, nga roli i saj i dobishëm dhe funksioni shoqëror që kryen, përbën një nga elementet më të rëndësishme të kulturës materiale. Po të bëjmë një analizë të hollësishme për veshjet tradicionale të Labërisë, do të shohim se ato kanë elemente të përbashkëta edhe me popujt e tjerë të Ballkanit. Këto elemente të përbashkëta e pika takimi nuk vihen re vetëm në disa aspekte të thjeshta, si në materiale, forma, ngjyra, dekore etj., por edhe në strukturën morfologjike të tyre. Kështu për shembull fjalën “gunë”, që në gjuhën shqipe e gjejmë edhe në formën “gunëza”, në bullgarisht e gjejmë me format “guna” dhe “gunja”, në serbo-kroatisht e gjejmë “gunë”, “gunj”, “gunjina”; në rumanisht e gjejmë “guna” e në greqisht e gjejmë “gun”.⁴

Po të vëmë re emrat e ndryshëm që përdoren në këtë objekt edhe në Shqipëri, shohim se në përgjithësi ata rrjedhin nga materiali i përdorur për përgatitjen e tij. Kështu kemi emrat “lëkurçe” dhe “gozhup”, për gunat e përgatitura me lëkurë; emrat “leshe”, “deleshe” dhe “leshnikë”, për gunat e përgatitura me lesh; “flokate” dhe “floçkë” nga materiali “flokë”; “shijak” dhe “shajak”, fjalë me origjinë turke; “kadife” dhe “allaxhia”. Fjala “gunë” është mjaft e lashtë dhe mund të themi se ajo e ka fillimin me dy lëkurat e kafshës që njeriu i primitiv i përdori për të mbuluar trupin para e prapa. Gustav Mejer shkruan se origjina e kësaj fjale është e errët. Shtrirja aq e gjerë e saj, në distanca aq të largëta dhe në popuj aq të ndryshëm, dëshmon për një origjinë mjaft të lashtë. Përsa i përket origjinës së kësaj fjale ka hipoteza të ndryshme, por ndër to është pranuar më tepër mendimi i Joklit, i cili mendonte se djepi i kësaj fjale do kërkuar ndër gjuhët e vjetra të Ballkanit dhe, pikërisht, nga fondi leksikor i trakishtes e ilirishtes së vjetër dhe se nga këta dy popuj të afërm në mes tyre u përhap në të gjithë pellgun e Mesdheut.⁵ Veshjet popullore në Labëri trashëgojnë mjaft elemente që vijnë nga periudhat më

⁴ Rr. Zojzi, *Guna në veshjet tradicionale të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë ballkanikë*, “Etnografia shqiptare”, III, Tiranë, 1966, f. 10.

⁵ Shih po aty.

të hershme të kulturës ilire, gjë që përcakton përkatësinë etnike të tyre. Po sjellim disa emërtime tipike nga leksiku për veshjen në krahinën e Labërisë.

bërruci (i punuar me lesh deleje), *brashaj* (opëngë e vjetër), *brezi prej leshi*, *brezi*, *çember* (përparësë), *cibuna* (flokata), *cipulli* (vello), *cohtë*, *cotë* (lloj stofi), *çepe* (flokë të gjatë tek meshkujt), *destemeli* (cepat e shamisë së kokës), *dollak*, *dolloma* (këmishë të gjatë e jelek), *dulluma* (fustan i gjatë), *duvak* (cipullë), *fanella prej leshi*, *fermele* (mantel pa mëngë), *feste shajaku*, *feste*, *flokati* (xhup leshi i bardhë), *fustan leshi*, *fustan shajaku*, *fustango* (fund këmishë me pala), *gajtanë me xhufka*, *gjerdan*, *guna e dhirtë* (e punuar me lesh dhie), *guna*, *hajmali*, *kabone* (lloj gune me shajak), *calcet* (prej shajaku që mbulonin këmbët e burrave), *kallca*, *fustanella*, *kaliqe* (nallane), *kallçina* (çorape burrash të gjata ku fusnin pantallonat), *këmishë bezeje* (për burra), *këpucët me profka*, *kësulë* (shami e bardhë që vendosej në kokë), *kokore leshi*, *kollanë me llustër* (brez), *korroçepe* (flokët e shkurtër), *kotoll* (këmishë grash e qëndisur), *krahë* (këmishë), *kukore me vesh*, *kundra* (opënga), *lahurë* (shami koke me thekë për gra), *lelekçe* (e veshur hollç), *lëkurçe* (lëkurë deleje), *libade* (xhup), *linja* (këmishë e gjatë prej leshi ose liri, me mëngë dhe e gjatë deri në fund të këmbëve për gratë dhe deri në kërci për burrat), *llabania*, *llapa* (kokore), *mantone*, *mandile* (shami), *mëngore* (për burra), *opënga me xhufkë*, *opënga të lopërta*, *pallacka* (veshje, stoli), *pallaganë* (veshje për fëmijë), *pano brekë* (pantallona të linjtë), *patiqe* (pupa leshi), *peshlliu* (prej cohe për burrat), *peshlliu* (veshje e leshte burrash që mbahet mbi linjën), *përvezgë* (ndërrësë fëmije), *polkë* (xhakëtë e shkurtër grash), *poture*, *profka* (pandofla), *qeleshe*, *qylaf, rupe* (stoli, zbukurime), *silah* (brez i gjerë i stolisur me dy xhepa për duhan), *sharku*, *shargonia* (*shark*), *sharp* (shami koke), *sherqe burrash*, *shollë* (opëga prej llastiku), *shollë qorsele* (këpucët) *shpargër* (mbulesë fëmijësh), *opënga*, *sumbulla* (kopsa), *sumbullat e jelekëve* (zbukurime), *tabaroja* (xhakëtë e gjatë), *tirq gjunjare*, *tirq kofshor*, *tirqit*, *triko*, *tumanet* (çitjanet), *veshje me xibunë*, *vraka* (pantallona leshi nga gjuri e poshtë të ngjitura pas kërcirit), *xana* (veshje me fije liri ose gjineshtre) *xhamadan* (jelek), *xharape leshi* (çorape), *xhufka*, *zhapat të argasura*, *zhapat të paargasura* (këpucët).

4. Leksiku nga veglat e punës

Si vegla kryesore të bujqësisë në këtë krahinë kanë qenë kryesisht ato të Antikitetit dhe Mesjetës së hershme si:

parmenda prej druri me plorin e hekurt, *kazma me një presë*, *shati*, *dhiqeli*, *kosorishteja*, *cekurja*, *drapëri i padhëmbëzuar*, *zgjedha*, *plisa*, *gërshëra për vreshta*, *kiza* e mprehte për krasitjen e vreshtave, *kraba* për vjeljen e ullinjve (një vegël e vogël prej hekuri në formë të pikëpyetjes), *vareja* për thyerje gurësh, *pompa* për spërkatje etj. Disa të tjera janë: *Parmënda*, *parmëndë me vesh* (në formë V), *parmëndë me llapar* (për tokat e buta). *Pjesët e parmendës*: *përdhesi*, *hosteni*, *litarët*, *plori*, *tërkuza*; *zgjedha*, *drapëri*, *kosa*, *kosori*, *lesa* (shërbente për shkoqjen e dheut), *masur* (bosht tjerreje), *makap* (qysqi), *plugu*, *qysqiu* (vegël për nxjerrjen e gurëve), *sirta*, *sopata*, *vareja*, *branë* (për endjen e leshit), *dhëmecër*, *llanarë*, *avlimend*, *telvikë*.

BIBLIOGRAFI

- A. Dhrimo (1974), *Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit I*, “Studime filologjike”, 3.
- A. Dhrimo (1974), *Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit II*, “Studime filologjike”, 4.
- A. Dhrimo, *Të dhëna nga toponimia e Labërisë si dëshmi për lashtësinë dhe njësinë e popullit shqiptar*, “Studime filologjike”, 1982/3, f. 133-141.
- B. Gaçe (2001), *Etnokultura e Labërisë* (maket) IKP, Tiranë.
- E. Çabej (1974), *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, “Studime filologjike”, nr. 1, Tiranë.
- Gj. Shkurtaj (2012), *Dialektet e shqipes*, Morava, Tiranë.
- Gj. Shkurtaj (2012), *Dialektet e shqipes*, Tiranë.
- M. Totoni (1964), *E folmja e Bregdetit të Poshtëm 2*, “Studime filologjike”, 2, Tiranë.
- M. Totoni (1964), *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, “Studime filologjike”, 1, Tiranë.
- M. Totoni (1965), *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, “Studime filologjike”, 3, Tiranë.
- M. Totoni (1971), *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë.
- R. Memushaj (2001), *Lidhjet tradicionale të Kurveleshit me Vlorën*, Konferenca shkencore, “Vlora në rrjedhat e kohës”, Toena, Tiranë.
- R. Memushaj (2004), *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Toena, Tiranë.
- Sh. Demiraj (1983), *Elemente gjuhësore arkaike në këngët e Kreshnikëve*, “Kultura popullore”, 2, Tiranë.

**GJUHËSI, LETËRSI,
MËSIMDHËNIE etj.**

